



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KRYETARI

Nr. 4712 prot.

Himarë, më 26.06.2026

URDHËR
Nr. 338 Datë 26.06/2026
PËR

**“KUFIZIMET NË QARKULLIMIN E MJETEVE RRUGORE TË RËNDA TË
TRANSPORTIT MALLRAVE/PERSONAVE GJATË SEZONIT TURISTIK”**

Mbështetur në pikën 2 të nenit 113 të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, ligjin nr. 139/ 2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 10431/2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, ligjin 8378/1998 “Kodi rrugor i Republikë së Shqipërisë”, ligjin 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjin 93/2015 “Për turizmin”, VKM-së Nr.153/2000 “Rregullorja për zbatimin e Kodit Rrugor”, Udhëzimit të përbashkët Nr.7967/2018 “Mbi kufizimet në qarkullimin e mjeteve të rënda për transportin e mallrave përgjatë sezonit turistik” dhe VKB Himarë Nr.15 datë 28.04.2026 “ Për miratimin e planit të punës, për menaxhimin e sukseshëm të sezonit turistik 2026 dhe planit të veprimit përkatës”. Me qëllim sigurimin e një sezoni të qëndrueshëm, krijimin e një mjedisi miqësor për pushuesit vendas dhe të huaj, duke eliminuar pengesat dhe bllokimet si rrjedhojë e qarkullimit të rënduar gjatë sezonit turistik:

URDHËROJ:

- 1- Të ndalohet për periudhën 27/06/2026 deri më 15/09/2026, qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë (duke përfshirë por pa u limituar, auto betoniere, autovinça, eskavatorë, fugonë, kamionë, etj.), me përjashtim të mjeteve të emergjencës, shërbimeve publike dhe rasteve të autorizuara me leje të posaçme nga autoritetet përkatëse, në pjesën bregdetare të territorit të qytetit Himarë, Njësia Administrative Himarë dhe Njësia Administrative Lukovë.
- 2- Të ndalohet qarkullimi i mjeteve rrugore të rënda për transportin e mallrave/personave mbi 3.5 tonë (duke përfshirë por pa u limituar: auto betoniere, autovinça, eskavatorë, fugonë, kamionë, etj.) në pjesën bregdetare të territorit të qytetit Himarë, Njësia Administrative Himarë dhe Njësia Administrative Lukovë.
- 3- Subjektet e licensuara për transportin e personave të marrin masa për njoftimin e pikave të ndalimit sipas orarit zyrtar të miratuar.
- 4- Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Policisë Bashkiake Himarë, Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë.

Ky urdhër hyn në fuqi më 27/06/2026.

KRYETARI
Vangjel Tave

